



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

KUSHTET E VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ("Autoriteti Kontraktues"),

dhe

KOMPANIA E SIGURIMEVE "ILLYRIA" SH.A, Prishtinë

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

"Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO"

Numri i identifikimit: 212-20-414-2-3-6

Numri i brendshëm: 212 20 004 236

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

16 Mars 2020

Nr. i Prokurimit: 212-20-414-2-3-6 / 212 20 004 236 Titulli: "Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO"

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **"Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO"**

Përshkrimi i shërbimit									
1	A. Sigurimi i automjeteve ndaj palëve të treta - TPL VW Passat 3C	164.62	18.00	194.25	1.00	Copë	164.62	194.25	29.63
2	A. Sigurimi i automjeteve ndaj palëve të treta - TPL Peugeot 407 2.0 HDI	197.54	18.00	233.10	1.00	Copë	197.54	233.10	35.56
3	A. Sigurimi i automjeteve ndaj palëve të treta - TPL Hunday accent crdi 1.6	132.96	18.00	156.89	2.00	Copë	265.92	313.79	47.87
4	A. Sigurimi i automjeteve ndaj palëve të treta - TPL Citroen C-ELYSEE 1.6 HDI 90	132.96	18.00	156.89	1.00	Copë	132.96	156.89	23.93
5	B. Sigurimi i automjeteve - TPL + (Plus)për shtetet e regjionit VW Passat 3C	49.39	18.00	58.28	1.00	Copë	49.39	58.28	8.89
6	B. Sigurimi i automjeteve - TPL + (Plus)për shtetet e regjionit Peugeot 407 2.0 HDI	59.26	18.00	69.93	1.00	Copë	59.26	69.93	10.67
7	B. Sigurimi i automjeteve - TPL + (Plus)për shtetet e regjionit Hunday accent crdi 1.6	39.89	18.00	47.07	2.00	Copë	79.78	94.14	14.36
8	B. Sigurimi i automjeteve - TPL + (Plus)për shtetet e regjionit Citroen C-ELYSEE 1.6 HDI 90	39.89	18.00	47.07	1.00	Copë	39.89	47.07	7.18
9	C. Sigurimi i automjeteve – KASKO e plotë VW Passat 3C	86.40	18.00	101.95	1.00	Copë	86.40	101.95	15.55
10	C. Sigurimi i automjeteve – KASKO e plotë Peugeot 407 2.0 HDI	80.00	18.00	94.40	1.00	Copë	80.00	94.40	14.40
11	C. Sigurimi i automjeteve – KASKO e plotë Hunday accent crdi 1.6	86.40	18.00	101.95	2.00	Copë	172.80	203.90	31.10
12	C. Sigurimi i automjeteve – KASKO e plotë Citroen C-ELYSEE 1.6 HDI 90	115.20	18.00	135.94	1.00	Copë	115.20	135.94	20.74
Totali i përgjithshëm								1,703.64 €	

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën: 16.03.2020. Kohëzgjatja e kontratës është 12 muaj.

Shërbimet do të kryhen menjëher pas nënshkimit të kontratës nga Operatori Ekonomik dhe sipas kërkesës së MAPL-së.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [] ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i [dërgimit të furnizimeve] [ekzekutimit të punëve] **[kryerjes së shërbimeve]** do të jetë: **Në lokacionin e Operatorit Fitues të Kontratës. KOMPANIA E SIGURIMEVE "ILLYRIA" SH.A, Prishtinë**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,703.64 €** [REDAKTUAR]
Njëmijë e shtatë qind e tri euro e gjashtë dhjetë e katër cent [REDAKTUAR].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [REDAKTUAR] [shërbimeve] [REDAKTUAR] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të [REDAKTUAR] [shërbimeve] [REDAKTUAR].

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [REDAKTUAR] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

Ndërtesa e ish "Rilindjes", kati i 12, Salla nr.1220, Divizioni i Prokurimit MAPL, Prishtinë

Personi përgjegjës i prokurimit i Autoritetit Kontraktues

Emri dhe Mbiemri: **Zelihe Morina**

Titulli: **U.D Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit**

Nr. i Tel: + 381 (038) 200 35 523

E-maili: **zelihe.morina@rks-gov.net**

Menaxher i proketit nga MAPL-ja:

Emri dhe Mbiemri: **Hashim Berisha**

Titull: Zyrtar i lartë i personelit

Nr. i telefonit: 038/ 200 35 650

E-mail: **hashim.berisha@rks-gov.net**

Adresa e Kontraktuesit:

KOMPANIA E SIGURIMEVE "ILLYRIA" SH.A, Prishtinë

Numri i Biznesit: 810483769

Nr. i llogarisë bankare: 111-0175807-000-182 PCB

Menaxheri i projektit nga Operatori Ekonomik

Emri dhe Mbiemri: **Lendi Kadriji**


Titulli: Menaxher

Nr. i telefonit: 049 750 834

E-mail: **lendi.kadriji@illyriainsurance.com**

Nr. i Prokurimit: 212-20-414-2-3-6 / 212 20 004 236 Titulli: "Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO"

E hartuar në gjuhën **Shqipe**² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		Operatorin Ekonomik: KOMPANIA E SIGURIMEVE "ILLYRIA" SH.A, Prishtinë	
Emri:	Zelihe Morina	Emri:	Lendi Kadriji
Pozita:	U.D Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit	Pozita:	Zyrtar i Marrjes në Sigurim
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.03.2020	Data:	06.06.2020
Vula:		Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.